

“HTM” SH.P.K

NIPTi: K97006004D

Lagjja L. Perash, Rr. Rrojej, Nr 44, Shkodër

V E N D I M

I Ortakut të Vetëm në cilësinë e Asamblesë së Përgjithshme

(Marrë në zbatim të neneve 168, 169 dhe 177 e në vijim të ligjit nr. 9901, datë 14.04.2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare”).

Sot në datën 24 Korrik 2019, Ortaku i Vetëm i shoqërisë në cilësinë e Asamblesë së Përgjithshme të Shoqërisë “HTM” SHPK, shqyrtoi projekt vendimet:

- 1) Rritjen e kapitalit të regjistruar të shoqërisë “HTM” SHPK me vlerë 65 000 000 LEKE me rezervat e disponueshme të akumuluar, pasqyruar në bilancin e vitit financiar që përfundon më 31.12.2018 dhe në bilancin e reformuar për periudhën Janar - Korrik 2019, në zbatim të nenit 177 të Ligjit Nr. 9901, datë 14.04.2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare”.
- 2) Caktimin e Audituesit Ligjor për të përgatitur raportin për zmadhimin e kapitalit të regjistruar për vlerën 65 000 000 LEKE
- 3) Të tjera

Ortaku i vetëm konstatoi se:

Në bilancin kontabël të vitit 2018 janë pasqyruar rezerva të disponueshme me vlerë 278 733 602 LEKE, të akumuluar nga shpërndarja e fitimeve të viteve të mëparshme me vendimet e Ortakut të viteve përkatëse. Fitimi i vitit 2018 gjithsej 20 347 118 LEKE ka kaluar në rezerva me vendimin e ortakut të datës 30.06.2019. Pas këtij transaksioni në bilancin e reformuar janë pasqyruar rezerva të disponueshme në total 299 080 720 LEKE. Nga totali i rezervave, 65 000 000 është vendosur të përdoret për rritjen e kapitalit të regjistruar dhe vlera 165 733 602 është kaluar në “fitime të paspërndara” për t’u shpërndarë dividend, si vijon:

Viti i krijimit	Vendimi i Asamblesë		Vlera e fitimit, kaluar në Rezerva
	Nr.	Datë	
Nga fitimi i vitit 2018	1	30.06.2019	20,347,118
Nga fitimi i vitit 2017 ¹	1	28.06.2018	165,733,602
Nga fitimi i vitit 2017 ²	1	28.06.2018	17,961,155
Nga fitimi i vitit 2016	1	29.06.2017	89,989,751
Nga fitimi i vitit 2015	1	30.06.2016	4,489,495
Nga fitimi i viteve deri në 31.12. 2014			559,599
Totali			299,080,720
Rezerva që do të kapitalizohen			(65,000,000)
Dividend të deklaruar datë 30.06.2019			(165,733,602)
Rezërva tjera në bilanc			68,347,118

¹ Nga fitimi i vitit 2017 gjithsej 183,694,757, kaluar në rezerva të disponueshme, 165 733 602 klasifikohet “fitim i paspërndarë për t’u shpërndarë si dividend dhe në rezerva të disponueshme mbetet 17 961 155 LEKE

² Vlera e rezervave të disponueshme nga shpërndarja e fitimit të vitit 2017 .



"HTM" SH.P.K

NIPTi: K97006004D

Lagjja L. Perash, Rr. Rrojej, Nr 44, Shkodër

Në përfundim Ortaku i vetëm,


VENDOSI:

1. Të rrisi kapitalin e regjistruar të shoqërisë "HTM" SHPK me rezervat e disponueshme të pasqyruara në pasqyrat financiare 2018 dhe bilancin e reformuar 2019 për vlerën 65 000 000 LEKE.

Viti i krijimit	Rezerva të kapitalizuara
Nga rezervat e tjera të vitit 2017	17,961,155
Nga rezervat e tjera të vitit 2016	47,038,845
Totali	65,000,000

2. Pas rritjes, kapitali i regjistruar i shoqërisë nga 100 000 bëhet 65 100 000 LEKE.
3. Rritja do të shlyhet me rezervat e disponueshme, pasqyruar në pasqyrat financiare 2018 dhe bilancin e reformuar.
4. Audituesi ligjor që do të përgatiti raportin për zmadhimin e kapitalit është Zj. Marije DUSHI, me liçence profesionale nr. 51, datë 26.01.2000 auditues - partner dhe ortakë e shoqërisë "FICADEX ALBANIA" SHPK.
5. Regjistrimi në QKR të bëhet brenda afatit ligjor.
6. Për kryerjen e veprimeve përkatëse në QKB Autorizohet Z. *Mirgjet Merollari*.

Ilir Tabaku
Ilir TABAKU
Ortak



“HTM” SH.P.K

NIPTi: K97006004D

Lagjja L. Perash, Rr. Rrojej, Nr 44, Shkodër

VENDIM

i Ortakut të Vetëm në cilësinë e Asamblesë së Përgjithshme

Sot, në datën 09 Gusht 2019, në selinë e shoqërisë tregtare “HTM” SHPK me adresë: “Lagjja L. Perash, Rr. Rrojej, Nr 44, Shkodër”, Ortaku i Vetëm i shoqërisë në cilësinë e Asamblesë së Përgjithshme të kësaj shoqërie shqyrtoi projekt vendimin:

1. Miratimin e Raportit të Audituesit Ligjor, i përgatitur për zmadhimin e kapitalit të regjistruar të shoqërisë “HTM SHPK me kalimin /(kapitalizimin) e rezervave të disponueshme;
2. Të tjera.

Pasi bëri shqyrtimet e duhura Ortaku i vetëm,

VENDOSI:

- 1) Miratimin e raportit të paraqitur nga zj. Marije DUSHI, Auditues Ligjor - ortake e shoqërisë “FICADEX ALBANIA” SHPK “për zmadhimin e kapitalit të shoqërisë nëpërmjet kalimit/ (kapitalizimit) të rezervave të disponueshme”, në zbatim të vendimit të ortakut me datë 24 Korrik 2019
- 2) Kapitali i regjistruar i shoqërisë zmadhohet me vlerën 65 000 000 LEKE. Pas zmadhimit, kapitali i regjistruar nga 100 000 LEKE bëhet 65 100 000 LEKE. Kapitali zotërohet 100 % nga Ortaku i vetëm Z. Ilir TABAKU.
- 3) Shlyerja 100% e vlerës së rritjes së kapitalit të regjistruar është bërë me kalimin e rezervave të disponueshme sipas Bilancit të reformuar me datë 05 Gush 2019.
- 4) Ky vendim të depozitohet në Q.K.B dhe në departamentin e kontabilitetit.
- 5) Për të kryer veprimet përkatëse në QKR lidhur me depozitimin e këtij vendimi, autorizohet Z.

Mirpa Kacollari

Ilir Tabaku

Ilir TABAKU

Ortak



“HTM” SH.P.K

NIPTi: K97006004D

Lagjja L. Perash, Rr. Rrojej, Nr 44, Shkodër

**DEKLARATË
E ADMINISTRATORIT**

Për gjendjen e aktiveve të shoqërisë

(Në zbatim të nenit 178 të Ligjit 9901, datë 14.04.2008 - i ndryshuar)

Unë i nënshkruari Ilir TABAKU në cilësinë e administratorit të shoqërisë “HTM” SHPK. deklaroj se në datën e zmadhimit të kapitalit në zbatim të nenit 177 të Ligjit 9901, datë 14.04.2008 (I ndryshuar) “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare” vërtetohet se gjendja e aktiveve të shoqërisë është e tillë që, nëse vendimi për zmadhim do të ishte marrë në datën e aplikimit për regjistrim pranë Qendrës Kombëtare të Regjistrimit, zmadhimi do të ishte ende i mundur.

Ilir Tabaku
Ilir TABAKU

Administrator - Ortak

